



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.37/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Nika Pharm SH.P.K me seli në Veternik, Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës (MPMS-IP), në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.33/22, të datës 25.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e paditësit Nika Pharm SH.P.K me seli në Veternik, Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.33/22, të datës 25.10.2022, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m i**

Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e atakuar KA.nr.33/22, të datës 25.10.2022 ka vendosur si ne vijim: REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Nika Pharm” Sh.p.k., me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi i Inspektoratit të Punës 214/2018 i datës 06.06.2018.

Kundër këtij Aktgjykimi, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka paraqitur ankesë, me të cilën pretendon se Aktgjykimi i Shkallës së Parë është i përfshirë në shkelje procedurale, andaj propozon që të merret Aktvendim duke Aprovuar si të bazuar juridikisht dhe faktikisht ankesa e Nika Pharm SH.P.K me seli në Prishtinë dhe të Anulohet si i kundërligjshëm Aktgjykimi KA nr. 33/22 i Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, me vendimin përfundimtar nr.214/2018 dt.06.06.2018, ka refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë palës Nika Pharm Sh.P.K me NB 70626926 me seli në Veternik – Prishtinë me pronar R.B.. Vërtetohet vendimi i Organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës Nr.105/18 datë 26.03.2018.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 25.10.2022, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, e duke u bazuar në provat siç janë: Vendim nr. 214/2018 i datës 06.06.2018 i Inspektorati të Punës; Raport Zyrtar nr. 70/2018 i datës 05.03.2018; Raport Zyrtar nr. 99/2018 i datës 19.03.2018; Vendim mbi shqiptimin e gjobës nr. 105/2018 i datës 26.03.2018; Ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë nr. 127/2018 i datës 16.04.2018. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me pretendimet e paditësit se e punësuar E.L. nuk ka qenë e punësuar por vetëm praktikante. Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë arsyetimin e të paditurit se në bazë të nenit 10 të Ligjit të Punës, punëdhënësi është i obliguar të lidhë kontratë punë në formë të shkruar, e cila kontratë duhet ti përmbajë elementet e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit të Punës dhe se edhe për rastet kur kemi të bëjmë me praktikantë, i punësuar është i obliguar që të mbajë evidencë të cilin këtu paditësi nuk e ka poseduar. Gjykata vlerësoi se Inspektorati i Punë gjatë inspektimit të subjektit “Nika Pharm” Sh.p.k. ka vepruar në kuadër të kompetencave për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të Punës, Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë dhe se në përputhje me nenin 92 të Ligjit të Punës, paditësit i ka shqiptuar gjobë për shkak të shkeljeve të cilat i ka konstatuar. Gjykata vlerëson se paditësi përmes padisë nuk ka arritur të vërtetojë gjendje faktike tjetër nga ajo që është konstatuar në procedurë administrative dhe atë se paditësi nuk ka përpiluar kontratat e punës në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Punës, nuk ka përcaktuar orarin e punës për të punësuar me qëllim të respektimit të pushimit javor sipas nenit 31 të Ligjit të Punës si dhe nuk ka mbajtur evidencë për praktikantë në përputhje me nenin 16 të Ligjit të Punës.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, sepse, me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale, dhe drejtë është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit të organit të paditur si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, sipas gjendjes faktike të vërtetuar, ku Inspektorati i Punës ka vlerësuar se në bazë të nenit 10 të Ligjit të Punës, punëdhënësi është i obliguar të lidhë kontratë punë në formë të shkruar, e cila kontratë duhet ti përmbajë elementet e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit të Punës dhe se i është i obliguar që të mbajë edhe evidencë të cilin këtu paditësi nuk e ka poseduar.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 6 par. 3 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë i cili përcakton: "Kundër vendimit të Inspektoratit të punës mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.". Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 2, të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë i cili përcakton se: "Inspektorati i punës: a) Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë b) Do t'i siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet me të efektshme të batimit të dispozitave ligjore. c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm. d) Do t'i siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t'i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese. e) Do t'i jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje", si dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i cili në nenin 3 përcaktuar: "Teksti të pika „a" e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin „Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë." Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara, nga provat si Raporti Zyrtar nr. 70/2018 i datës 05.03.2018 gjykata ka konstatuar se Inspektorati i Punës me datë 05.03.2018 ka bërë inspektim tek subjekti "Nika Pharm" Sh.p.k., me adresë në rr. "Vellezerit Gervalla", Ferizaj dhe kanë obliguar punëdhënësin që në afat prej 7 ditëve të dorëzënë kontratat e punës për të punësuarit, dëshmitë e pagesës së pagave mujore për vitin 2018, dëshmitë e pagesës së kontributeve pensionale për vitin 2017 dhe 2018, vendimet për shfrytëzimin e pushimit vector për vitin 2017 dhe orarin e punës për punëtorë në baze të ndërrimeve dhe pushimeve javore.

Po ashtu nga prova e arsyetuara në aktgjykimin e atakuar, si: raporti zyrtar nr. 99/2018 i datës 19.03.2018, gjykata ka konstatuar se Inspektorati i Punës me datë 19.03.2018 ka bërë vizite riinspektuese tek paditësit nga ku kanë konstatuar se paditësi ka prezantuar kontratat e punës për të punësuarat V.K. dhe T.Xh. por të njëjtat nuk janë në harmoni me Ligjin e Punës pasi që në nenin 11 të Kontratave thuhet se të punësuarit i takon pushimi vjetor me pagesë prej 18 ditë pune ndërsa nën 32 i Ligjit të Punës përcakton se të punësuarit i takojnë 4 javë pushim me pagesë. Gjithashtu kanë konstatuar se edhe në vendimet për pushim vjetor është përcaktuar se të punësuarve ju takojnë 18 ditë pune pushim. Inspektorati i Punës po ashtu ka konstatuar se punëdhënësi nuk ka hartuar orarin e punës në përputhje me rekomandimin e IP të dhënë gjatë vizitës së parë, pasi që nuk ka theksuar se kush mbulon ditët e punës shtese gjatë punës në ditët e vikendit, pasi që paditësi punon 7 ditë në javë në dy ndërrime. Krejt në fund ka theksuar se gjatë vizitës kanë hasur duke punuar edhe E.L. për të cilën nuk u prezantua asnjë dokument ndërsa nuk ka dorëzuar kontratë punës edhe në afatin shtesë të dhënë deri me datë 23.03.2018, andaj gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me pretendimet e paditësit se të punësuarat E.L. nuk ka qene e punësuar por vetëm praktikante, por se në bazë të nenit 10 të Ligjit të Punës, punëdhënësi është i

obliguar të lidhe kontrate pune në formë të shkruar, e cila kontrate duhet të përmbajë elementet e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit të Punës dhe se edhe për rastet kur kemi të bëjmë me praktikante, i punësuar është i obliguar që të mbajë evidence të cilin këtu paditësi nuk e ka poseduar.

Andaj Gjykata e shkallës së parë në vendimin e atakuar drejt vlerësoi se Inspektorati i Pune gjatë inspektimit të subjektit "Nika Pharm" Sh.p.k. ka vepruar në kuadër të kompetencave për të mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të Punës, Ligjit për Siguri në Pune, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në pune dhe se në përputhje me nenin 92 të Ligjit të Punës, paditësi i ka shqiptuar gjobë për shkak të shkeljeve të cilat i ka konstatuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 38 dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative si në vështrim të nenit 43.1 të LKA-së si dhe shkresave të tjera, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe ka vendosur për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kolegji i gjykatës, konstaton se në këtë çështje juridike administrative, nga organi administrativ përfundimtar, MPMS-TEIP, dhe gjykata e shkallës së parë drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila rezulton se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, aktgjykimi i ankimuar është i kuptueshëm përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të

cilat i aprovon edhe kolegji, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë, andaj i njëjti vlerësohet në tërësi si i drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.37/23 datë 25.04.2024**

**Kryetar i Kolegjit,**  
**Faton Bajrami**